




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raport i II
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin nëntor 2017





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës e partnerë të biznesit,

Në detyrën e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin e dytë të trajtimit të ankesave, në kuadër të njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer gjatë secilit muaj.

Përmes këtij dokumenti, në funksion të transparencës ju raportojmë kërkesat dhe sugjerimet e ardhura nga ju gjatë muajit nëntor si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Gjithsej kemi trajtuar 48 kërkesa, prej të cilave 29 kërkesë/ankesa, pas këshillimeve dhe gjetjes së hapësirave ligjore për të trajtuar çështjet, janë zgjidhur.

Çdo propozim që na mbërrin nga grupet e ndryshme të interesit, sipërmarrësit, apo shoqatat, koordinohet me ministrinë përkatëse të parashikuara për zgjidhjen specifike të secilës çështje, ndaj një pjesë e këtyre propozimeve janë në proces përpunimi dhe do të raportohen në vijim.

Duke besuar se marrëdhënia Qeveri-sipërmarrje ka hyrë tashmë në një fazë të re, atë të konkretësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, lutem konsiderojeni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni cdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	10.10.2017	Subjekti shoqëri transporti raporton se ka një vendim gjykate të formës së prerë në favor të tij dhe kërkon zbatimin e vendimit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.2	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	11.10.2017	Subjektet bënë kërkesë për ngritjen e Urdhërit të Inxhinierëve.	Trajtuar me përgjigje në ndjekje deri në mbarim të procedurave.
Nr.3	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.10.2017	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.4	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	22.10.2017	Subjekti kërkon rinovimin e kontratës me ISSH.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit	23.10.2017	Subjekti kërkon ndërtim të impjantit të energjisë në zonën ku ushtron aktivitetin.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.6	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1.11.2017	Subjekti raporton vendosje gjobe për pasaktësi në prerjen e kuponit tatimor. Gjoha 330 herë më e lartë se vlera e kuponit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1.11.2017	Subjekti raporton gjobitje te padrejtë dhe kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.8	ZRPP	1.11.2017	Subjekti ka marrë lejen e përdorimit të objektit në Bashki ndërkohë që nuk është regjistruar në ZRPP	Trajtuar me përgjigje dhe ndihmë në regjistrimin në ZRPP
Nr.9	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	3.11.2017	Subjekti kërkon rilidhje të kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike. Subjekti raporton pengesa proceduriale.	Trajtuar me përgjigje, në ndjekje.
Nr.10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5.11.2017	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.11	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	7.11.2017	Paqartësi ligjore për nënshkrimin elektronik dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.	Trajtuar me përgjigje sqaruese.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.12	Bashkia Koplík	8.11.2017	Subjekti ka raportuar probleme në lidhje me taksën mbi infrastrukturën.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.13	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	11.11.2017	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së si fasoneri që në muajin qershor dhe pse ligji e parashikon brenda një afati 30 ditor.	Trajtuar me përgjigje në ndjekje deri në mbarim të procedurave.
Nr.14	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.11.2017	Subjekti raporton mos-rinovim autorizimi për pajisje fiskale pa shpjegim.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.15	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.11.2017	Subjekti kërkon leje për vënien në qarkullim të produkteve.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.16	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	13.11.2017	Subjekti kërkon zbatimin e kontratës nga ana e Autoritetit Portual Durrës.	Trajtuar me zbatim.
Nr.17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	13.11.2017	Subjekti denoncon veprime korruptive të administratës.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.18	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	13.11.2017	Subjekti ka parashtruar ankesë ndaj kontrollit të AKU, Fier.	Trajtuar përgjigje.
Nr.19	Ministria e Drejtësisë	14.11.2017	Subjekti është gjobitur nga inspektorët në masën 50.000 lekë	Trajtuar me verifikim.
Nr.20	OSSHE	15.11.2017	Subjekti kërkon sjelljen e energjisë elektrike në biznes.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.21	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	17.11.2017	Subjektit i janë bllokuar llogaritë bankare si pasojë e një vendimi gjykatë. Subjekti i drejton kërkesë OSSHE për mos-faturim të energjisë deri në zgjidhjen e problemit .	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.22	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	19.11.2017	Subjekti eksportues për shkak të problematikës logjistike, paraqet kërkesë për përmirësimin e infrastrukturës detare.	Trajtuar, në shqyrtim e sipër.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.23	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	19.11.2017	Subjekti kërkon ndalimin e firmave fallco.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.24	ZRPP	21.11.2017	Subjekti raporton problematikë në regjistrimin në ZRPP.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.25	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	22.11.2017	Subjekti bën kërkesë për rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.26	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	23.11.2017	Subjekti bën kërkesë për lejen për nisjen e fluturimeve.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.27	ZRPP	23.11.2017	Subjekti raporton problematika në lidhje me regjistrimin në ZRPP.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.28	Ministria e Drejtësisë	25.11.2017	Subjekti kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës për zhblokimin e sekuestrimit të mallit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.29	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	26.11.2017	Subjekti raporton se administrata kërkon ekstrakte QKB, vërtetime tatimore etj. me skadencë 3 mujore.	Trajtuar me përgjigje.



